



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje/Department of Education

Në bazë nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 84 dhe 85 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, neni 5, neni 14 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarrjes së Subvencioneve Nr.1427 të datë 28.04.2017, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit shpall



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

-IV- Nr. 1 prot. 1214 Më
Br. prot. Dt. 17.4.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

KONKURS

Për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026:

1. Bursat ndahen për vitin akademik 2025/2026 për shkollimin universitar.
2. Numri i bursave të planifikuara është **100** (njëqind) bursa.
3. Lartësia e bursës është **60 €** (gjashtëdhjetë euro) për muaj, për gjithsej 9 (nëntë) muaj.
4. Lartësia e bursës është **70 €** (shtatëdhjetë euro) për studentë që kanë notën mesatare mbi **9 (nëntë)**, për gjithsej 9 (nëntë) muaj.
5. Lartësia e bursës për studentët e fushave defecitare;
6. Matematikës, është **100 €** (njëqind euro) për muaj, për gjithsej 9 (nëntë) muaj.
7. Fizikë dhe Kimi, është **80 €** (tetëdhjetë euro për muaj), për gjithsej 9 (nëntë) muaj.
8. Mjekësi e përgjithshme– Universiteti “Hasan Prishtina”, është **100 €** (njëqind euro) për muaj, për gjithsej 9 (nëntë) muaj.
9. Lartësia e bursës për studentët me notën **10.00 (dhjetë)**, është **100 €** (njëqind euro) për muaj, për gjithsej 9 (nëntë) muaj. Vlenë për studentët që kanë të përfunduar së paku të gjitha provimet e vitit të I-rë të studimeve.

Për ndarjen e bursave për nxënës të ShML-ve dhe të IAAP-së për vitin shkollor 2025/2026:

1. Bursat ndahen për vitin shkollor 2025/2026 për shkollimin e mesëm të lartë.
2. Numri i bursave të planifikuara është **35** (tridhjetë e pesë) bursa;
3. Lartësia e bursës është **35 €** (tridhjetë e pesë euro) për muaj, për gjithsej **9 (nëntë) muaj**.

Kriteret për ndarjen e bursave për studentë:

- Lëmia e studimit;
- Suksesi gjatë studimeve (nota mesatare);
- Gjendja ekonomike familjare;
- Kategoritë e dala nga lufta.

Kriteret për ndarjen e bursave për nxënës:

- Të jetë nxënës i rregullt;
- Të jetë nxënës i shkëlqyeshëm;
- Gjendja e dobët ekonomike familjare.

Kohëzgjatja e akordimit (dhënies së bursës):

- Bursa akordohet me kohëzgjatje prej 1 (një) viti me të drejtë vazhdimi, nëse përfituesi i bursës ka regjistruar me sukses vitin pasues dhe të ketë rezultatin e studimeve jo me të dobët se vitin paraprak.

Dokumentet e nevojshme për aplikim të bursës për studentë:

- Kërkesa me biografi të shkurtër;
- Vërtetimi me të cilin vërtetohet fusha e studimit;
- Certifikata e notave;
- Fotokopja e ID-kartelës;
- Dëshmi mbi gjendjen sociale- nëse familja është në asistencë sociale
- Vërtetimi me të cilin vërtetohet Prindërit e studentëve që aplikojnë janë pjesë e kategorive e dala nga lufta;
- Kopja e letënjoftimit;
- Certifikata e lindjes.
- Konfirmimi i xhirrollogarisë bankare.

Dokumentet e nevojshme për aplikim të bursës për nxënës:

- Vërtetimi nga shkolla;
- Dëshmi për suksesin e nxënësit (certifikatë e notave);
- Certifikata e lindjes;
- Konfirmimi i xhirrollogarisë së prindit.

Për studentët: të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët e regjistruar në universitetet publike.

Për nxënësit: të drejtë aplikimi kanë vetëm nxënësit e regjistruar në shkollat publike, të komunës së Rahovecit.

Kohëzgjatja e konkursit:

- Afati i konkurimit është 20 (njëzet) ditë pune nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik;
- Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Dokumentet dorëzohen në zyret e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit;
- Afati i fundit për aplikim është data 18 maj 2026, deri në orën 16:00.

Rahovec,
17.04.2026

Muhamet Morina

